



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2021:276665

Datë: 23.04.2024

Numri i dokumentit: 05609234

**PAKR.nr.744/2023**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, Departamenti i Krimeve të Rënda – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Kadrije Goga Lubishtani - kryetare e kolegjit, Vaton Durguti dhe Skender Çoçaj – anëtar të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gresë Latifi, në çështjen penale kundër të akuzuarit L.A. nga fsh. K., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale të kanosjes nga neni 181 par.4 të KPRK-së, duke vendosur lidhur më ankesën e mbrojtësit të akuzuarit L.A., av.K.Z., të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Krimeve të Rënda, me numër të lëndës 2022:197211, të datës 17.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 të KPPK-se, me datë 03.04.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit L.A., av.K.Z., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Krimeve të Rënda, me numër të lëndës 2022:197211 i datës 17.11.2023, **VËRTETOHET**.

## Ar sy e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj - Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktgjykimin me numër të lëndës 2022:197211 i datës 17.11.2023, të akuzuarin L.A., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, dhe për këtë veprë penale e ka dënuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj ndërsa për veprën penale të kanosjes nga neni 181 par.4 të KPRK-së i ka shqiptuar dënim me burg në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muaj. Konform dispozitës ligjore të neni 76 par. 2 nën par.2.2 të KPRK-së, të akuzuarin L.A., e ka gjykuar me dënim unik me burg në kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) muaj, të cilin dënim do ta vuaj menjëherë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë. Konform nenit 57 të KPRK-së, i llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 08.12.2021 deri me 07.01.2022.

Të dëmtuarit K.M. dhe S.M., me vendbanim në Kukës R. Shqipërisë, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Është obliguar i akuzuari që konform nenit 450 par.3 dhe 452 par.1 të KPPK-së, në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50 Euro (pesëdhjetë), dhe nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 50 Euro (pesëdhjetë), në afatin prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi të marr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

### **Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar:**

Mbrojtësi i të akuzuarit L.A. av. K.Z. për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, të aprovoj ankesën si të bazuar, aktgjykimin e ankimuar ta anuloj në tërësi ose pjesërisht ose ta ndryshoj dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në gjykim të serishëm.

Prokuroria e Apelit me parashtrësën, PPA/I.nr.675/2023, datë 29.12.2023 ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit L.A. av.K.Z. të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi Gjykatës Themelore në Ferizaj – Departamenti i Krimeve të Rënda me numër të lëndës 2022:197211 i datës 17.11.2023, të vërtetohet.

Gjykata e Apelit caktoj dhe e mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPRK-së, në të cilën ka prezantuar i akuzuari L.A., ndërsa nuk kanë prezantuar Prokurori i Apelit, mbrojtësi i të akuzuarit av.K.Z., të dëmtuarit K.M. dhe S.M. edhe pse kanë qenë të njoftuar me rregull për ditën dhe kohën e mbajtjes së seancës.

Gjykata e Apelit e Kosovës mbajti seancën e kolegjit gjyqësor dhe shqyrtoj shkresat e lëndës, gjithashtu vlerësoj aktgjykimin e kundërshtuar në kuptim të nenit 394 të KPP-së, dhe pas vlerësimit të pretendimeve në ankesë gjeti se; **Ankesa është e pabazuar.**

### **Pretendimet e mbrojtësit në ankesë**

Në ankesë mbrojtësi i të akuzuarit L.A., av.K.Z., thekson se Gjykata në aktgjykimin e atakuar ka bërë *shkelje esenciale të dispozitave* të KPPRK-së, por mbrojtja nuk i thekson këto shkelje nga se gjykata e shkallës së dytë ato i konstaton sipas detyrës zyrtare. Më tej shton se nuk është konstatuar drejtë *gjendja faktike* me aktgjykimin e atakuar nga se arma për të cilën është shpallur fajtor as që ka ekzistuar dhe këtë nuk kanë mund ta konfirmojnë në dëshmitë e tyre edhe dëshmitarët, kurse me një dëshmi të dëshmitarit nuk mund të shpallet i akuzuari fajtor e as të dënohet. Njëkohësisht, arma as që është sekuestruar nga ana e organit kompetent si objekt i veprës penale, nga se ajo as që ka ekzistuar, kurse prova materiale as që kanë ekzistuar. Po ashtu, edhe vepra penale kanosja nuk është vërtetuar nga se ajo nuk ka qenë serioze e as e realizueshme e as që ka shkaktuar ankth dhe frikë të dëmtuari dhe kjo nuk është vërtetuar me asnjë provë.

Gjykata, *gjatë matjes dhe shqiptimit të dënimit* nuk veproi drejt konform nenit 73 par. 1 të KPRK-së nga se nuk pati parasysh në mënyrë të mjaftueshme qëllimin e dënimit, nuk u zbatua në mënyrë eksplicite dispozita ligjore e nenit 74 e KPRK-së, pasi që gjykata ka mundur të i shqiptoj një dënim më të butë dhe jo të i shqiptoj dënimin prej 1 viti dhe se mendoj se ka pasur vend për aplikimin e rrethanave veçanërisht lehtësuese në vend të dënimit me burg nga 1 vit të i shqiptoj një dënim më të ulët, kur merret parasysh personaliteti i të akuzuarit, i pa dënuar më parë, shkallën e përgjegjësisë penale, kur i akuzuari nuk është në gjendje të i kuptoj plotësisht veprimet e tija (e kjo më së miri është parë edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor), pasojat e shkaktuara dhe një mori rrethanash tjera që ka mund të i aplikoj gjykata dhe të shqiptoj dënim më të butë ndaj atij që e ka shqiptuar me aktgjykimin e ankimuar. Konform nenit 395 të KPPRK-së, Gjykatës së Apelit në Prishtinë si gjykatë e shkallës së dytë i propozoj edhe atë, që gjatë

shqyrtimit të ankesës për rastin konkret meqenëse ankesa është paraqitur vetëm në dobi të akuzuarit, të ketë parasysh posaçërisht faktin sa i përket vlerësimit juridik të veprës penale dhe lartësisë së dënimit mos ta ndryshoj vendimin e sanksionit penal në dëm të akuzuarit - Reformatio in peius.

### **Gjetjet e Gjykatës së Apelit**

Gjykata e Apelit gjen se, pretendimi ankimor përkitazi me shkeljen esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat në ankesë mbrojtja thekson se i shqyrton sipas detyrës zyrtare vet gjykata e shkallës së dytë, janë të pabazuara dhe si të tilla nuk qëndrojnë pasi që aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 të KPP-së, për të cilat sipas detyrës zyrtare kujdeset kjo gjykatë, e të cilat do të kishin kushtëzuar anulimin e detyrueshëm të aktgjykimit të ankimuar. Kjo ngase dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i qartë, i kuptueshëm dhe konkret dhe se është në përputhshmëri të plotë edhe me arsyetimin dhe përpilimin e dispozitivit të tij, ndërsa në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, janë dhënë arsye e duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështje penale-juridike, duke vepruar kështu konform dispozitës të nenit 369 par. 6 të KPPK-së, ku gjykata e shkallës së parë ka paraqitur arsye për çdo pikë të aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së parë, ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe vlerësimin e provave e ka bërë në pajtim me dispozitat e nenit 360 par.1 dhe 2 të KPPK-së, kështu që në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye të qarta dhe konkrete për vendin, kohën dhe mënyrën se si ka ardhur deri të kryerja e veprës penale nga i akuzuari, dhe se nga provat e administruara ka ardhur në përfundim të drejtë se i akuzuari ka kryer veprat penale për të cilën është akuzuar, pra gjykata e ka bërë analizën e të gjitha provave të procedura gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta objektive dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo gjykatë.

Sa i përket pretendimeve ankimore përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, Gjykata e Apelit e Kosovës gjen se ky pretendim ankimor është i pabazuar. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë edhe gjendjen faktike në këtë çështje penale e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, ngase me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari L.A. në mënyrën e përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, i ka kryer veprat penale për të cilat është shpallur fajtor, ashtu që i akuzuari me datë 31 Tetor 2021

rreth orës 15:30 në fshatin G., komuna F., ka poseduar armën në kundërshtimin me nenin 5 të Ligjit mbi armët numër 05/L-022, në atë mënyrë që me pushkën automatike AK-47, të cilën e ka siguruar nga persona tani të panjohur, ka shkuar në fshatin G. në vendin ku ishin duke i ruajtur delet dy barinj, shtetas të Republikës së Shqipërisë të cilët e kanë njoftuar policinë, mirëpo i pandehuri ishte larguar nga vendi kurse armën e kishte fshehur vëllai i tij, kurse pas disa dite e ka zhvendosur në një vend të panjohur dhe nuk ka mundur të sekuestrohet nga policia, dhe po ashtu me datë, kohë dhe vend të njëjtë siç përshkruhet në pikën I të dispozitivit të lartcekur, i akuzuari ka kanosur seriozisht me armë të dëmtuarit K.M. dhe S.M., shtetas të Republikës së Shqipërisë, në atë mënyrë që derisa të dëmtuarit ishin duke i ruajtur delet e pronarit Z.R., i pandehuri ka shkuar me veturën e tij “Pick Up”, ngjyrë e bardhë dhe i ka kërcënuar të dëmtuarit me fjalët “kush ju ka thënë që ti fusni delet në këto livadhe, largohuni prej këtu dhe le të vjen Z. le ti marrë delet”, e pastaj ka nxjerr armën nga vetura dhe e ka mbushur me municion, me ç’ rast të dëmtuarit nga frika kishin ikur nga vendi i ngjarjes.

Deri tek kjo gjendje faktike, gjykata e shkallës së parë ka ardhur pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor, siç janë: deklarata e të dëmtuarit K.M. dhe S.M., dëgjimi i dëshmitarëve R. A. dhe Z.R., raporti i policisë 2021-CF-2213 të dt.31.10.2021, si dhe shkresa të tjera të lëndës. Nga dëshmia e të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarit K.M., vërtetohen faktet relevante të kësaj çështje penale, se të akuzuarin e ka takuar me datën kritike dhe për gjatë gjashtë (6) viteve sa ka punuar çoban në Kosovë ka pasur vetëm një problem me L.A. në atë mënyrë që ditën kritike S.A. ju ka thënë “shtini delet në livadhin tim”, por ky u përgjigjet “jo se na bërtet L.” pasi i kanë vendos delet në livadh ka ardh L. me një veturë Pik Up, u thotë “kush ju ka thënë ti vendosni delet këtu”, dëshmitari i tregon që me leje të S. kushëririt tuaj, por L. reagoi keq duke vendos dorën në një fjqok brenda veturës e ka marr një armë të llojit kallash dhe filloi ta mbush duke i kanosur “largohuni nga këtu dhe le të vjen Z. mi marr delet” nga frika ne u larguam delet i lamë në livadh të S. menjëherë e lajmëruam Z. i cila ka ardh, nga ky rast jemi kthyer në Shqipëri dhe kemi ndërprerë punën te Z.

Po ashtu nga dëgjimi i të dëmtuarit, në cilësinë e dëshmitarit, S.M., vërtetohen faktet relevante të kësaj çështje, se ditën kritike ishte duke i ruajtur delet së bashku me K.M., delet i kanë vendosur në një livadh të kushëririt të L. sepse vet kushëriri iu tha ti vendosin delet aty, dëshmitari e pyet “mos po na bërtet L.” por ky kushëriri ju tha “nëse ju bërtet me thirrni sepse toka është e imja” pak pas ka ardh L. me një veturë Pik Up, ngjyrë të bardhë dhe u thotë “kush ju ka thënë ti vendosni delet këtu” dhe ka nxjerr një armë e ka mbushur me municion e ka mbajtur

te poshtë në veturë dhe u thotë “ikni dhe lëreni delet aty, le të vije pronari ti merr” dëshmitarët menjëherë kanë ik nga frika dhe kanë ftuar pronarin i cili është paraqitur në vend ngjarje por që L. i kishte larguar më parë, dëshmitari vërteton se arma ishte e llojit kallashnikov dhe ky personalisht i njeh mirë armët nga rasti i njohur për opinionin i vitit 1997 në Shqipëri. L. armën e ka marr mbi kokë sikur vetura ta kishte një lloj rafti sipër dhe ka zgjatur dorën e ma marr kallashnikovin dhe i ka vendos municion, e ka repetit dhe tytën e kallashnikovit e ka mbajtur mes dy këmbëve të veta me tytë për veture.

Nga dëshmia e dëshmitarit Z.R., është vërtetuar se i njëjti jeton dhe vepron në Gjermani, ka investuar në një fermë të dheneve dhe posedon 1500 (njëmijë e pesëqind) krerë dele, ka pasur të punësuar ndër të tjerë edhe K.M. dhe S.M. dhe që të dy nga ky rast më nuk kanë ardh të punojnë. Ditën kritike ka pranuar një telefonatë nga punëtorët se L. i ka kërcënuar punëtorët dhe i kishte qortuar pse i kanë vendos delet në atë livadh në pronësi të S., ky i fundit iu kishte thënë që ti vendosim delet për kullotë në pronën e tij, vetë S. i ka shprehur keqardhje për rastin e ndodhur në pronën e tij. Dy barinjte i thonë në telefon se delet i ke vet kurse ne ikëm dhe lata po ju thotë “nëse Z. është burrë le të vij personalisht dhe ti tërhek delet”, dëshmitari fillimisht ka menduar se po bënë bëjnë hajgare kur ndërkohë ka pranuar edhe telefonatën e dytë për të njëjtat fakte, menjëherë është nis për të vendi i ngjarjes dhe gjatë rrugës e ka telefonuar L. i cili i thotë se jam duke të prit, por me të arrit në vend ngjarje L. vetëm ishte larguar, në vend ngjarje barinjte nuk ishin sepse L. i kishte kërcënuar me kallash në dorë, këtë fakt ja kanë pohuar barinjte.

Nga dëshmia e dëshmitarit R.A. të dhënë në shqyrtim gjyqësor me dt.23.08.2023, i njëjti ka theksuar se e din arsyen për çka do të dëshmoj, për një armë të llojit automat për të cilën është deklaruar edhe në polici, deklaratën e konfirmon se e ka nënshkrua me vullnet dhe bindje të plotë por nuk i përmbahet kësaj me arsyetim se nga disa persona që blinin hekurishte nga R. Shqipërisë i kanë ofruar që ta blinin automatikun, ky personalisht ia ka marr dhe vetëm e ka vendos brenda në shtëpi sa për ta bërë një foto dhe nga frika e babait ja kam kthyer personave të njëjtë, në polici kam thënë se e ka mixha por isha i bindur se mixha nuk me rrah edhe jam frikësuar nga policia kur kanë bastisur shtëpinë, policët e kanë sugjeruar ta denoncojnë mixhën për shkak që ka një vepër me disa çobanë, nuk e njeh Z.R. nuk ka parë dhe nuk din kush ka dele.

Për të njëjtën çështje penale në deklarinimin e dhënë në Stacion Policor me dt.08.12.2021, ka dëshmuar se para tri (3) jave axha jonë L. e ka sjell një pushkë automatike të tipit kallashnikov pa fishekë, gjë që i ka thënë do ta lë aty për një kohë, me të njëjtën pushkë atë ditë i kishte

kanosur dy barinj të deleve të Z.R., axha e ka lënë pushkën rreth dhjetë (10) ditë për arsye që është frikësuar se policia do ti bastisin shtëpinë dhe mos të ja gjejnë, pas dhjetë (10) dite unë personalisht me dorën time ai kam kthyer pushkën axhës L. dhe më nuk e di se ku e ka lënë. Dëshmitari pohonte se armët mirë nuk i njoh por kjo arma ishte e llojit kallashnikov, të njëjtën armë e kam vendosur në dhomën e fjetjes nën krevet, plus i ka bërë disa foto.

Pra, nga të cekurat si më lart, duke analizuar dhe vlerësuar dëshmitë e dëshmitareve-të dëmtuarve dhe dëshmisë së këtij dëshmitari të dhënë në polici, e cila deklaratë vërteton pohimet e të dëmtuarve përkitazi me posedimin e kësaj arme nga i akuzuari, edhe kjo gjykatë gjen se gjykata e shkallës së parë në këtë çështje penale ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, andaj rrjedh pa dyshim se në këtë çështje penale faktet relevante të kësaj çështje penale janë vërtetuar me provat e administruara në shqyrtim gjyqësor dhe në këtë drejtim nuk ka mbetur asnjë fakt në nivel dubioz, si pretendon mbrojtja në ankesën e saj.

Andaj, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës vlerëson se, pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit të paraqitura në ankesë mbi këtë bazë janë të pabazuara dhe si të tilla nuk qëndrojnë ngase pas analizimit të shkresave të lëndës rezulton se ka prova të mjaftueshme, përkatësisht me provat e administruara në shqyrtim gjyqësor vërtetohet se i akuzuari L.A. ka kryer veprat penale për të cilat është shpallur fajtor. Pretendimet ankimore, për konstatim jo të drejtë të gjendjes faktike përkitazi me faktin se arma për të cilën është shpallur fajtor as që ka ekzistuar dhe këtë nuk kanë mund ta konfirmojnë në dëshmitë e tyre edhe dëshmitarët, kurse me një dëshmi të dëshmitarit nuk mund të shpallet i akuzuari fajtor e as të dënohet, po ashtu pretendimi se arma as që është sekuestruar nga ana e organit kompetent si objekt i veprës penale, ngase ajo nuk ka ekzistuar, prova materiale as që kanë ekzistuar, si dhe vepra penale kanosja nuk është vërtetuar nga se ajo nuk ka qenë serioze e as e realizueshme e as që ka shkaktuar ankth dhe frikë te i dëmtuari dhe kjo nuk është vërtetuar me asnjë provë, janë pretendime të pabazuara dhe të njëjtat si të tilla nuk qëndrojnë. Kjo pasi që pas, si është theksuar edhe më lartë, pas analizimit të shkresave të lëndës dhe aktgjykimit të ankimuar, kolegji penal i kësaj gjykate gjen se gjendja faktike është vërtetuar drejtë ngase gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit për të akuzuarin L.A. nuk është mbështetur në një të vetme deklaratë, ashtu siç pretendon mbrojtësi i të akuzuarit, por nga deklaratat e dëshmitarëve të lartcekur e po ashtu edhe nga provat që mbështesin këto deklarata, andaj me të drejtë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të pandehurit janë përmbushur elementet e veprës penale *Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim*

*të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPK-së dhe veprës penale kanosja nga neni 181 par. 4 të KPRK-së për të cilat edhe është shpallur fajtor.*

Po ashtu lidhur me pretendimin ankimor se tek vepra penale kanosja nuk është vërtetuar e njëjta ngase kanosja nuk ka qenë serioze e as e realizueshme e as që ka shkaktuar ankth dhe frikë te i dëmtuari ky kolegji penal vlerëson se është pretendim i pabazë kjo për faktin se nga deklaratat e të dëmtuarve rezulton se të njëjtit pas ngjarjes së ndodhur nuk kanë vazhduar punën për shkak të situatës së ndodhur të shkaktuar nga i akuzuari L.A., për të cilën edhe e kanë njoftuar pronarin tek i cili kanë qenë duke punuar Z.R. dhe të njëjtit janë kthyer në Shqipëri, gjë që nga kjo rezulton qartazi se të njëjtit nga këto veprimet e të akuzuarit nga frika që i është kanosur janë larguar nga vendi i punës dhe janë kthyer në vendlindjen e tyre, në R. të Shqipërisë.

Andaj, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës duke u bazuar në të gjitha këto që u thanë më lart, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, për faktin se në këtë çështje penale nuk ka mbetur pa u vërtetuar asnjë fakt vendimtar.

Gjykata e Apelit gjen se, me aktgjykimin e ankimuar nuk është shkelur as ligji penal, siç pretendon mbrojtësi i të akuzuarit, në ankesën e tij. Kjo për faktin se në veprimet e të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprave penale për të cilat i njëjti është shpallur fajtor, se për këto vepra penale i njëjti është penalisht përgjegjës, si dhe nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të akuzuarit. Duke shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar përkitazi me vendimin mbi dënimin, Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet ankimore e mbrojtësit të akuzuarit për një dënim me të butë, me pretendim se *gjatë matjes dhe shqiptimit të dënimit* gjykata nuk veproi drejt konform nenit 73 par. 1 të KPRK-së nga se nuk pati parasysh në mënyrë të mjaftueshme qëllimin e dënimit, nuk u zbatua në mënyrë eksplicite dispozita ligjore e nenit 74 e KPRK-së, pasi që gjykata ka mundur të i shqiptoj një dënim më të butë dhe jo të i shqiptoj dënimin prej 1 viti dhe se mendoj se ka pasur vend për aplikimin e rrethanave veçanërisht lehtësuese, janë pretendime të pabazuara. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit i ka vlerësuar të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, ku si rrethanë lehtësuese vlerësoi sjelljen korrekte dhe përgjigjes në ftesat e gjykatës, i gjendjes së dobët ekonomike, relaksim të raportit me pronarin e kopesë së deleve që ishte shkak, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërit vepra të tilla apo të ngjashme, ndërsa si rrethanë rënduese



vlerësoi peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë dhe rrezikshmërinë shoqërore, i gjykuar me vendim të formës së prerë, P.nr.272/18, të dt.23.10.2019 dhe P.nr.272/19 të dt.28.10.2019, andaj duke vlerësuar rrethanat e përmendura të akuzuarit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me bindje se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa rrethanat e pretenduara lehtësuese të theksuara nga mbrojtësi i të akuzuarit, si marrja parasysh e personalitetit e të akuzuarit, i pa dënuar më parë, shkallën e përgjegjësisë penale, kur i akuzuari nuk është në gjendje të i kuptoj plotësisht veprimet e tija (e kjo më së miri është parë edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor), pasojat e shkaktuara dhe një mori rrethanash tjera që ka mund të i aplikoj gjykata dhe të shqiptoj dënim më të butë, janë rrethanat të cilat tani më janë vërtetuar dhe vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë, e ndryshe nga ato rrethanat si pretendon mbrojtja në ankesën (i pa dënuar më parë) andaj, edhe kjo Gjykatë është e bindur që dënimi i shqiptuar të akuzuarit si në aktgjykimin e ankimuar rezulton të jete në kuadër të rrethanave të gjetura dhe të vlerësuar, prandaj të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Prandaj, kjo Gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e Gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprave të kryera penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe më intensitetin e rrezikimit apo pasojave të shkaktuara dhe se më të do të mund të parandalohet i pandehuri nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të parandalohen personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Nga arsyet e lartcekura u vendos si në dispozitive të këtij aktgjykimi konform nenit 401 të KPPRK-së.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PAKR.nr.744/23, datë 03.04.2024**

**Bashkëpunëtorë Profesionale,**

---

**Kryetare e kolegjit,**

---

Numri i lëndës: 2021:27665  
Datë: 23.04.2024  
Numri i dokumentit: 05609234

**Gresë Latifi**

**Kadrije Goga Lubishtani**

**Vaton Durguti**

---

**Skender Çoçaj**

---